



MISIONI  SHQIPTAR

Shën Nënë Tereza

Saint Mother Teresa Albanian Mission
739 Browns Line, Etobicoke, Ontario M8W 3V7
Tel. 416 503 4509 dhe 647 558 9382
www.misioninenetereza.com

Çdo të dielë në orën 11:30 Rruzarja dhe Mesha Shenjte

Ejani

22 Korrik 2018

Come into the silence of solitude,
and the vibration there will talk
to you through the voice of God.

Paramahansa Yogananda

quotefancy

Në atë kohë, apostujt u bashkuan prapë te Jezusi dhe i treguan gjithçka kishin bërë dhe kishin mësuar. Atëherë ai u tha: “Ejani dhe ju në një vend të pabanuar e pushoni pak në vetmi.” Sepse aty aq shumë njerëz vinin e shkonin sa që s’kishin kohë as të hanin. Ata u nisën me barkë për në një vend të pabanuar, në vetmi. Porse njerëzit i panë në ç’drejtim u nisën e shumica e morën me mend vendin ku do të shkonin dhe, këmbë, prej të gjitha qyteteve, shkuan atje e arritën para tyre. Kur Jezusi doli nga barka, pa një turmë të madhe të popullit, iu dhimbtën, sepse ishin porsë ‘dhentë pa bari’, e filloi t’u mësojë shumë gjëra. Mk 6, 30-34

Mesha Shenjte....

Mesha kremtohet çdo të dielë në orën 11:30 AM te Kisha: Our Lady of the Miraculous Medal, **739 BROWN'S LINE, Etobicoke**, M8W 3V7 (Browns Line & Evans Avenue) Phone (416) 255-2721. Kisha ndodhet menjehere mbrapa Slovenia Credit Union.

Kalendari liturgjik...

23 Korrik	Shën Brigita
24 Korrik	Shën Sarbeli
25 Korrik	Shën Jakobi apostull
26 Korrik	Shën Prenda
27 Korrik	Shën Joakimi dhe Ana
29 Korrik	Shën Marta

Haku Kishës 2018...

Aleks	Dragu
Aleks	Coku
Anton	Malaj
Arben	Therqaj
Arben	Pepa
Arben	Toma
Arben	Lekaj
Beniamin	Hasko
Brigen	Toma
David	Shtjefhilaj
Dod	Ndreu
Edi	Linadi
Edmond	Gjeta
Edmond	Gashaj
Eduard	Avullija
Eduard	Gega
Fatmir	Qosaj
Fatmir	Gega
Fred	Kalaj
Frederik	Gjergji
Gac	Gjoka
Gent	Gjeta
Gjelosh	Vushaj
Gjergj	Gjinaj
Gjergj	Nikolla
Gjeto	Marinaj
Ilir	Shyti
Ilir	Frrokaj
Kreshnik	Kapaj
Ladi	Lumaj
Lec	Gashaj

Lec	Ndoj
Luigj	Gjokaj
Luigj	Cukaj
Luigj	Gojani
Luk	Gjolaj
Luvigj	Lallinaj
Mario	Martini
Mark	Ndoci
Mark	Shkreli
Martin	Pjetri
Martin	Vuktilaj
Mhill	Ftoni
Mikel	Paplekaj
Ndoc	Bregu
Nush	Kaçaj
Paulin	Ndoj
Petrit	Ujka
Pjerin	Kalaj
Pjerin	Bruçaj
Pjeter	Dreshaj
Prek	Spaqi
Prek	Gjonaj
Rajmonda	Derza
Sokol	Ujka
Suela	Mangelli
Tome	Ivanaj
Tot	Prekulaj
Valete	Gjokaj
Viktor	Gjoka
Vitor	Mernacaj
Zef	Deklaj

Per Fondin e ndertimit te Kishes ka dhene ...

Ton Vocaj	20000
Pjeter&Bep Dreshaj	12000
Anton Malaj	11000
Sokol Sterbyci	11000
Prek Gjonaj	10000
Lec Gashaj	10000
Aleks Coku	9000
Fred Kalaj	7000
Luigj Narkaj	6000
Luk Gjokaj	6000
Sokol Noshi	6000
Elis Bzhetaj	5000
Arben Toma	5000
Kreshnik Kapaj	5000

Mario Martini	5000	Dede Ukaj	1000
Miri Sufaj	5000	Don Ambroz Demaj	1000
Paulin Marku	5000	Erald Islami	1000
Tonin Kastrati	5000	Ferdinand Grabanica	1000
Arben Pepa	5000	Gentjan Lelcaj	1000
Anton Brunga	4000	Gezim Lanazi	1000
Luvigj Lallinaj	4000	Gjon (Gjoro) Kaçaj	1000
Mirash Lallinaj	4000	Gjon Dreshaj	1000
Nush Dokaj	4000	Ladi Lumaj	1000
Pjerin Bruçaj	4000	Lec Ndoj	1000
Tom Prekulaj	4000	Lek Ramaj	1000
Dritan Lumaj	3000	Leke Koja	1000
Nik Biqi	3000	Leonard Pepaj	1000
Prek Spaqi	3000	Mark Ndoci	1000
Prek Lekaj	3000	Martin Marashaj	1000
Mhill Bregu	3000	Martin Pjetri	1000
Altin Miri	2500	Mhill Ftoni	1000
Albert Berisha	2000	Ndoc Bregu	1000
Aleks Dragu	2000	Ndue Cacakaj	1000
Artan Vuksani me vellezer	2000	Ndue Kabashi	1000
Besnik Arinaj	2000	Nikolin Vukelaj	1000
Edi Linadi	2000	Paulin Ndoj	1000
Edmond Ramaj	2000	Peri Kercaj	1000
Ergys Ndreu	2000	Petrit Stolaj	1000
Fabjan Pllumaj	2000	Pjerin Vukcaj	1000
Gjelosh Vushaj	2000	Pjeter Preka	1000
Jetnor Smakaj	2000	Prek Kaçaj	1000
Klodian Tafilaj	2000	Prek Spaqi	1000
Luigj Gojani	2000	Prel Pushaj	1000
Martin Vuktilaj	2000	Qamil Llashtica	1000
Ndok Gjokaj	2000	Shçiprim Lumi	1000
Petrit Ujkaj	2000	Viktor Gjokaj (Dokaj)	1000
Pjerin Kalaj	2000	Vilson Prekaj	1000
Shpend Pllumbaj	2000	Ylli Beqiri	1000
Sokol Gashaj	2000		
Sokol/Petrit Ujka	2000		
Vasel Nush Dreshaj	2000		
Gjergj Gjinaj	1500		
Gjovalin Melaj	1500		
Lek Selmani	1500		
Ndue Selmani	1500		
Sokol Kaçaj	1500		
Aleksander Stolaj	1000		
Angjelin Kaçaj	1000		
Angjelin Rrashkadolli	1000		
Anton Shelinaj	1000		
Arben Therqaj	1000		
Ardian Stolaj	1000		

Zoti ua shperblefte ne te mira e ua shtofte!

Kardinal Marx: “Nuk mund të jemi nacionalistë e katolikë” (R.SH. - Vatikan)

Kardinali Reinhard Marx: nacionalizmi “nuk është opcion për të krishterët”.

Djali është populist e si të gjithë populistët, fillimisht të frikëson e pastaj, sjell përçarje dhe urrejtje. Kështu pohon në një intervistë për gazetën gjermane “Die Zeit”, kryetari i Konferencës Ipeshkvnore Gjermane, kardinali Reinhard Marx, kryepeshkëv i Mynihut dhe Frisingës. Sipas tij, nacionalizmi nuk është “opcion për të krishterët”. “Njeriu është, për natyrën e vet, solidar dhe i gatshëm të ndihmojë. Por, kur frika ia errëson ndjesitë, bëhet i brishtë”, thekson prelati, për të cilin, në Evropë po

afirmohet një radikalizëm në rritje, së pari, në gjuhën e përdorur. “E shoh me shqetësim – pohon. – Kjo bën që refugjatët të paraqiten si kërcënim kundër mirëqënies sonë”. Shpesh, flitet vetëm për numra e për një lloj kërcënimi anonim, që u përhapka me shpejtësi.

Populizmi është tundim, shpjegon kardinali. “Armiku i natyrës njerëzore është djalli, siç pohon Shën Injaci i Lojollës, sepse na bën ta shohim tjetrin si armik. Kjo është edhe pasoja e populizmit. Së pari, përpiket të na frikësojë, pastaj, arrijnë mosbesimi, zilia, armiqësia dhe urrejtja e, së fundi, dhuna dhe lufta”.

Evropa të mos kthehet në fortesë... Të jesh nacionalist e katolik njëkohësisht, është e pamundur, nënvizon kardinali gjerman. “Si të krishterë, jemi si patriotë, ashtu edhe qytetarë të botës. Në politikë, prirja aktuale sheh vetëm kuadrin kombëtar, orientohet drejt afirmimit të vetvetes. Kjo është një mënyrë për t’i parë gjërat, që nuk na përket: duam të ruajmë mirëqënien tonë, por ajo mendohet se po kërcënohet nga jashtë. Evropa nuk duhet të kthehet në fortesë: kjo është bindja jonë e përhershme... Jam dakord me politikanin Jean Monnet: Evropa në vetvete, duhet të jetë kontribut për një botë më të mirë: krijuese, me dyer të hapura e kureshtare”.

Imzot Pjetër Budi më 20 korrik 1621 emërohet ipeshkëv i dioqezës së Sapës e Sardës

Imzot Pjetër Budi bëri përpjekje politike për të krijuar mbështetje e ndihma për rezistencën shqiptare kundër pushtimit të Perandorisë Osmane. Veproi për kauzën shqiptare, në një situatë politike teje të vështirë, duke synuar lirimin e popullit nga pushtimi e trysnia turke..

Imzot Pjetër Budi u lind në Gur të Bardhë të zonës jugore të Matit, në vitin 1566. Formimin e tij meshtarak dhe studimet filozofike e teologjike i bëri në Kolegjin Ilirik të Loretos dhe në moshën 21 vjeçare u shugurua meshtar dhe menjëherë u dërgua të shërbente me mision në Maqedoni e Kosovë që aso kohe ishin nën juridiksionin kishtar të kryedioqezës së Antivarit, (Bari i sotëm në Mal të Zi), ku ndjeji për 12 vjet.

Gjatë qëndrimit dhe misionit të tij meshtarak në Kosovë, dom Pjetër Budi hyri në kontakt me françeskanët e Bosnjës, një marrëdhënie kjo që i shërbeu në vitet e mëvonshme e në përpjekjet e tij politike për të krijuar mbështetje e ndihma për rezistencën shqiptare kundër pushtimit të Perandorisë Osmane. Në vitin 1599, dom Pjetër Budi qe emëruar Vikar i Përgjithshëm i Kishës katolike të Serbisë, detyrë e rol të cilin e mbajti për 17 vjet.

Si përfaqësues i Kishës katolike në Ballkanin e pushtuar nga turqit, Budi veproi pa dyshim në një situatë politike teje të vështirë e me tensione të mëdha, aq më tepër kur e konsiderojmë angazhimin e tij politik për kauzën shqiptare, sepse Budi synonte lirimin e popullit të vet nga pushtimi e trysnia turke. Për këtë ai pati kontakte me figura të mëdha të rezistencës siç ishte kroati Franjo Brtucevic e kryengritësit shqiptarë.

Në vitin 1615 dom Pjetër Budi shkon në Romë ku ndenji deri më 1618 për t’i botuar veprat e tij në gjuhën shqipe. Nga marsi i vitit 1618 e deri në shtator të vitit 1619, Budi shkoi në shtegtim në Santiago të Kompostelës në Spanjë. Pasi u kthye në Romë në vjeshtë të vitit 1619 u angazhua të informonte Kurien Romake mbi gjendjen e mjerueshme të të krishterëve në Shqipëri e në vise tjera të Ballkanit nën pushtimin turk. Prandaj kërkoi ndihma materiale e financiare për të mbështetur rezistencën që synonte çlirimin nga zgjedha turke.

Më 20 korrik të vitit 1621, Pjetër Budi u emërua ipeshkëv i Sapës e Sardës e një vit më vonë e nisi misionin e tij ipeshkëvnor në Shqipëri, ku kryesisht zhvilloi aktivitete të natyrës atdhetare e politike. Në dhjetor të vitit 1622 duke kaluar lumin Drin, humbi jetën. Vdekja e tij tragjike mbetet një enigmë.

Po kujtojmë veprat e tij. Vepra e parë e ipeshkëvit shqiptar imzot Pjetër Budit qe **“Doktrina e Kërshtenë”** që është përkthim i katekizmit të Shën Boberto Bellarminit, botuar në Romë më 1618. Nga aspekti letrar, më shumë se katekizmit, janë me interes 53 faqet e poemave fetare, që përbëjnë shembullin e parë të poezisë në dialektin Gegë. Disa prej poemave janë përkthim nga latinishtja ose italishtja mirëpo një pjesë e mirë janë origjinale.

Disa botime tjera të Imzot Budit qenë: **Ritual i Romak,** një përmbledhje me ritin e Meshës, të sakramenteve të ndryshme, të lutjeve e komenteve të pjesëve biblike në gjuhën shqipe.

Pastaj kemi edhe një përmbledhje prej 16 faqesh mbi shpjegimin e Ritit të Meshës. Po vepra më e njohur e imzot Pjetër Budit është **“Pasqyra e të Rrëfyemit”**, përkthim e adaptim i veprës **“Speculum Confessionis”** e Emerio de Bonis. Imzot Pjetër Budi është poeti i parë shqiptar që shkroi vargje, afër 3.300 rreshta vargjesh fetare në kuadrin me rimë të alternuar.

ARRA
LAW FIRM

Anisa Arra, BSc, JD
Barrister & Solicitor

P. 905.491.6977
F. 905.491.6974
anisa@arralawfirm.com

www.arralawfirm.com

466 Morden Road, Suite 202
Oakville, ON L6K 3W4

BRUNGA LAW
BARRISTERS & SOLICITORS

Anton Brunga | Lawyer

- Real Estate
- Immigration Law
- Testaments
- Business & Corporate Law
- Visas & Sponsorships
- Prokura & Family Law

416-234-5111
www.brungalaw.com